

Kreshnik Bajraktari

Z. Kreshnik Bajraktari mban pozicionin si Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor duke filluar nga data 27 Tetor 2025.

Me mbi 14-vite eskperencë, Z. Bajraktari ka spikatur me profesionalizmin e tij në fushën e transportit, inxhinierisë dhe manaxhimit të projekteve infrastrukturore, si në sektorin publik ashtu edhe në atë ndërkombëtar.

Karriera e tij profesionale ka reflektuar një ecuri të konsoliduar drejt përgjegjësive më të larta ku përpara emërimit të tij si Drejtor i Përgjithshëm i DPSHTRR-së, z. Bajraktari ka mbajtur rolin si **Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit Portual Durrës**. Ai ka drejtuar proceset e modernizimit dhe digjitalizimit të portit më të madh të vendit, duke forcuar standardet e sigurisë dhe efikasitetin operacional. Nën drejtimin e tij, Porti i Durrësit ka njohur përmirësime të ndjeshme në menaxhim, bashkëpunim ndërinstitucional dhe zhvillim të qëndrueshëm.

Përgjatë vitit 2024 ai ka ushtruar detyrën e **Këshilltarit për Transportin** pranë **Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë**, ku ka kontribuar në hartimin e politikave të zhvillimit të qëndrueshëm të transportit dhe modernizimin e sistemeve rrugore e hekurudhore.

Më herët ka mbajtur pozicione drejtuese dhe teknike si **Inxhinier i Sistemeve të Sinjalizimit dhe Komandë-Kontrollit**, si dhe për një periudhë të gjatë (2014–2022) ka qenë **Përgjegjës i Qendrës së Kontrollit të Trafikut Urban të Tiranës**, ku ka udhëhequr zhvillimin dhe zbatimin e sistemeve inteligjente të transportit (ITS), menaxhimin e trafikut rrugor dhe optimizimin e trafikut urban.

Eksperienca e tij përfshin gjithashtu bashkëpunime me organizata ndërkombëtare si **UNOPS** dhe **Agjencia Japoneze e Bashkëpunimit Ndërkombëtar (JICA)**, në projekte që lidhen me përmirësimin e infrastrukturës, sigurisë rrugore dhe transportit të qëndrueshëm.

Z. Bajraktari është diplomuar në **Inxhinieri Mekanike** dhe ka përfunduar **Master Shkencor në Konstrukione Mekanike të Mjeteve të Lëvizshme** pranë **Universitetit Politeknik të Tiranës**. Ai është trajnuar në programe ndërkombëtare të planifikimit të transportit urban dhe të qëndrueshëm në **Japoni** dhe **vendet e Bashkimit Europian**.

Falë përvojës teknike dhe aftësive manaxheriale, Z. Bajraktari sjell në krye të DPSHTRR-së një vizion të qartë për modernizimin e shërbimeve të transportit, digjitalizimin e proceseve dhe rritjen e sigurisë rrugore në nivel kombëtar.